



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

RREGULLORE

Nr. 21/6, Datë 10.06.2020

**PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN E PROCEDURËS SË
KONKURIMIT DHE EMËRIMIT TË OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE TË
SEKSIONEVE TË PROKURORISË**

Në mbështetje të nenit 18, pika 3, të Ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, pasi mori dhe miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm,

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Miratton këto rregulla:

Për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të Seksioneve të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë.

Neni 1

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për organizimin e procedurës që ndiqet për konkurimin dhe emërimin e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të policisë gjyqësore që funksionojnë pranë prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Neni 2

Emërimi

1. Emërimi i oficerëve të Polcisë Gjyqësore në seksionet e policisë gjyqësore të Prokurorisë, bëhet nga Komisioni i Policisë Gjyqësore me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Emërimi i oficerëve të Policisë Gjyqësore në seksionet e policisë gjyqësore të Prokurorisë,

bëhet sipas parashikimeve të neneve 10, pika 1, gërma "b", 17 dhe 18 të Ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", bazuar në një proces të hapur dhe transparent konkurimi.

Neni 3

Rishikimi i organikës dhe vendet e lira

1. Prokurori i Përgjithshëm pasi rishikon organikën e seksioneve të policisë gjyqësore pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe konstaton nevojën e plotësimit të vendeve vakante, bën shpalljen publike të vendeve të lira.
2. Shpallja e vendeve të lira bëhet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe afishohet në ambiente të dukshme të godinës së Prokurorisë së Përgjithshme dhe godinën e prokurorisë së rrethit gjyqësor ku janë krijuar vendet e lira.
3. Shpallja e vendeve vakante bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së caktuar për konkurim.
4. Shpallja e vendeve të lira duhet të përmbajë numrin e vendeve të lira për oficerë të policisë gjyqësore, për të cilat do të bëhet konkurimi, seksionin e policisë gjyqësore ku janë shpallur vendet e lira, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në konkurim, fazat në të cilat do të kalojë konkurimi, listën e dokumentave që duhet të dorëzojnë aplikantët dhe afatin e dorëzimit të tyre.

Neni 4

Paraqitja e dokumentacionit

1. Kandidatët që shfaqin interes për të marrë pjesë në konkurim duhet që brenda afatit të përcaktuar nga Prokurori i Përgjithshëm të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentacionin e kërkuar, i cili, duhet të përmbajë:
 - a) Kërkesën për t'u emëruar oficer i policisë gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore ku është shpallur vendi vakant,
 - b) Jetëshkrimin e detajuar të kandidatit,
 - c) Kopjen e diplomës dhe listës së notave, të arsimit të lartë dhe çdo dokument që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas ligjislacionit në fuqi për arsimin e lartë,
 - d) Librezën e punës ose çdo dokument tjetër që vërteton përvojën në punë të kandidatit si jurist në institucionet publike, private ose profesionet e lira ose në fushën e specialitetit të kërkuar ose si oficer i policisë gjyqësore në shërbimet e policisë gjyqësore.
 - e) Vlerësime të mëparshme të punës,
 - f) Dëshmi të gjuhëve të huaja dhe dëshmi të trajnimeve që ka kryer (nëqoftë se ka),
 - g) Dëshmi penaliteti që tregon se kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe vërtetime nga gjykata dhe prokuroria që vërtetojnë se nuk është në ndjekje penale apo gjykim për kryerjen e ndonjë vepre penale.

- h) Dokument që vërteton se ndaj kandidatit nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore dhe se në momentin e konkurimit nuk ka filluar procedim disiplinor ndaj tij.

Neni 5

Komisioni i vlerësimit të aftësive

1. Prokurori i Përgjithshëm, për zhvillimin e konkurimit ngrë një komision të përbërë nga tre anëtar, prokuror, nga të cilët, një prokuror caktohet në cilësinë e kryetarit dhe dy të tjerët në cilësinë e anëtarit.
Në rastet kur konkurimi zhvillohet për rekrutim të specialistëve të fushave të ndryshme të ekspertizës, në përbërje të Komisionit të Vlerësimit caktohet dhe një ekspert nga fusha përkatëse e ekspertizës.
2. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e aftësive të kandidatëve për Oficer të Policisë Gjyqësore në Seksion, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregullore dhe pas përfundimit të konkurimit, të nxjerrë menjëherë rezultatet përfundimtare.
3. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të deklarojnë paraprakisht nëse ndonjëri prej tyre është në kushtet e konfliktit të interesit me kandidatët që marrin pjesë në konkurim. Në rast se anëtari i Komisionit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, zëvendësohet nga Prokurori i Përgjithshëm me një prokuror tjetër nga trupa e prokurorëve, ose punonjës tjetër të fushës përkatëse, kur konkurimi zhvillohet për specialist të fushave të ekspertizës.
4. Komisioni i Vlerësimit ndihmohet në punën e tij nga administrata e Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 6

Procedura e konkurimit

1. Konkurimi zhvillohet në dy etapa:
 - a) Verifikimi paraprak, i cili, ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të përcaktuara në nenin 17 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” dhe të publikuara në shpalljen për konkurim.
 - b) Vlerësimi i kandidatëve.
2. Verifikimi paraprak bëhet mbi bazën e dokumentave (fotokopje) të paraqitura nga kandidatët dhe kryhet nga Sektori i Burimeve Njerëzore, në Prokurorinë e Përgjithshme, brenda 15 ditëve nga data e mbylljes së pranimit të dokumentave.
3. Pas përfundimit të vlerësimit paraprak, Sektori i Burimeve Njerëzore, harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 17 i ligjit 25/2019 “Për

organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”. Renditja në listë bëhet sipas rendit alfabetik dhe i dorëzohet Komisionit të Vlerësimit të Aftësive.

4. Lista me kandidatët e kualifikuar shpallet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme si dhe afishohet në ambientet e brendshme, të dukshme të këtij institucioni.
5. Kandidatët, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurim, Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme i rendit në një listë të veçantë, në të cilën, tregohen dhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kriterëve. Lista administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.
6. Brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, sipas pikës 5, të kësaj rregullore, kandidatët që nuk janë kualifikuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë Komisionit të Vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
7. Pas vlerësimit paraprak të kryer nga Sektori i Burimeve Njerëzore, kandidatët e kualifikuar, i nënshtrohen vlerësimit nëpërmjet testimit profesional. Vlerësimi i kandidatëve nëpërmjet testimit profesional kalon në tre faza nëpërmjet një procesi pikëzimi dhe përfshin:
 - a) Faza e parë, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës në punë e të trajnimeve të lidhura me fushën;
 - b) Faza e dytë, Vlerësimi me shkrim ;
 - c) Faza e tretë, Intervista e strukturuar me gojë;
8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
 - a) Për fazën e parë në të cilën vlerësimi sipas arsimimit, përvojës së punës dhe jetëshkrimit, kandidatët mund të marrin deri në 15 pikë, duke ndjekur shkallët e pikëzimit për:
 - i. Përvojën në punë mbi 5 vjet.
 - ii. Arsimi përfshirë diplomë pasuniversitare,
 - iii. Vlerësimi i mëparshëm i punës dhe njohuri kompjuterike, gjuhë të huaja dhe kualifikime të tjera.
 - b) Për fazën e dytë, në të cilën kryhet testimi profesional nëpërmjet zhvillimit të testimit me shkrim, kandidatët mund të marrin deri në 50 pikë. Testimi me shkrim përmban një test teorik dhe një test praktik.

Programi për testimin me shkrim përgatitet nga Komisioni i Vlerësimit përpara shpalljes së vendeve vakante dhe u vihet në dispozicion kandidatëve me paraqitjen e dokumentave sipas nenit 2 të kësaj rregullore. Testimi me shkrim kryhet për njohuritë

e përgjithshme dhe specifike nga fusha e të drejtës penale materiale dhe të drejtës penale procedurale, kushtetuta, karta e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe fusha e ekspertizës në rastet kur kërkohen njohuri specifike.

Komisioni vlerësimi 24 orë përpara zhvillimit të fazës së testimit me shkrim zgjedh pyetjet për testimin e fushës së njohurive, aftësive e të cilësive që nevoiten për ushtrimin e funksionit nga oficeri i policisë gjyqësore.

Komisioni pasi ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve njofton kandidatët për orën vendin dhe kohën, se kur do të kryhet testimi me shkrim. Ky njoftim duhet të bëhet pesë ditë para kryerjes së tij. Njoftimi bëhet nëpërmjet shpalljes në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme dhe në ambjentet e godinës së saj.

Nëse kandidati grumbullon mbi 40 pikë nga vlerësimi i jetëshkrimit dhe vlerësimi me shkrim, kualifikohet për intervistën e strukturuar më gojë.

- c) Për fazën e tretë, intervista e strukturuar me gojë, e cila, ka për qëllim vlerësimin e njohurive, aftësive dhe formimit të kandidatëve, kandidatët mund të marrin deri në 35 pikë.

Intervista me gojë përqëndrohet në njohuritë e përgjithshme të kandidatëve, të cilat tregojnë formimin tërësor të tyre, njohuritë në fushën e zbatimit të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, njohurit mbi normat që parashikon Kodin Penal, dhe akteve të tjera ligjore që gjejnë zbatim në hetimin e procedimeve penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur si dhe aktet ligjore të cilat rregullojnë përgjimin parandalues dhe procedurjal.

Komisioni i Vlerësimit, ditën e intervistës së strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët. Gjithashtu Komisioni cakton dhe datën se kur do të zhvillohet intervista me gojë dhe njofton kandidatët e kualifikuar.

9. Komisioni i Vlerësimit në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve harton listën e kandidatëve duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë.

Lista me renditjen e kandidatëve sipas pikëve i dërgohet Prokurorit të Përgjithshëm brenda 24 orëve nga përpilimi i saj.

10. Prokurori i Përgjithshëm, për kandidatët fitues sipas listës kryen verifikimet e nevojshme për pastërtinë e figurës në institucionet përkatëse.

Në përfundim të procedurës së verifikimit, Prokurori i Përgjithshme përpilon listën me emrat e kandidatëve, nga e cila do të përzgjidhen emrat fitues sipas parashikimeve të nenit 18, pika 2 e ligjit nr.25/2019.

Në listën e emrave nga e cila do përzgjidhen emrat sipas parashikimeve të nenit 18, pika 2 e ligjit 25/2019, futen kandidatët që në përfundim të konkurimit kanë grumbulluar mbi 70 pikë dhe plotësojnë kriterin e pastërtisë së figurës.

Rezultatet e konkurimit u njoftohen kandidatëve.

11. Në përfundim të procedurës së parashikuar nga dispozitat e mësipërme të kësaj rregullore, Prokurori i Përgjithshëm, me qëllim që propozimi për kandidatin të jetë në përshtatje me profilin e kandidatit/kandidatëve fitues dhe nevojat që kanë prokuroritë ku janë shpallur vendet vakant, i kërkon mendim drejtuesit të prokurorisë përkatëse. Pasi ka marrë mendimin e drejtuesit të prokurorisë përkatëse Prokurori i Përgjithshëm, për zgjedh kandidaturën/kandidaturat më të përshtatshme dhe u kërkon atyre që para marrjes së hapave për nxjerrjen e aktit administrativ për emërimin si oficer të policisë gjyqësore, të japin pëlqimin për kryerjen e trajnimit fillestar për hetim, parashikuar nga neni 17, gërma “ç” e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.
12. Në rast se kandidati i shpallur fitues nuk pranon ose tërhiqet nga kryerja e trajnimit fillestar, Prokurori i Përgjithshëm vijon procedurën me një nga kandidatët e tjerë fitues të listës, sipas parashikimeve të pikes 10 të kësaj rregullore.
13. Pasi kandidatët e përzgjedhur nga Prokurori i Përgjithshëm si më të përshtatshëm japin pëlqimin për kryerjen e trajnimit fillestar për hetimin, Prokurori i Përgjithshëm ia propozon emrat e tyre, Komisionit të Policisë Gjyqësore, për emërim, në përputhje me nenin 18, pika 2 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.
14. Komisioni i Policisë Gjyqësore shqyrton propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm në mbledhjen e tij më të afërt dhe në përfundim të shqyrtimit, kur propozimi pranohet, nxjerr aktin administrativ të emërimit të kandidatit/kandidatëve të propozuar si oficer i policisë gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë.
15. Pas nxjerrjes së aktit administrative të emërimit nga Komisioni i Policisë Gjyqësore, kandidatët e emëruar si oficerë të policisë gjyqësore, kryejnë trajnimin fillestar për hetim, në përputhje me kërkesat e neneve 17 dhe 27 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.
16. Kandidatët e emëruar nga Komisioni i Policisë Gjyqësore, fillojnë ushtrimin e funksioneve të oficerit të policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, ku janë caktuar, pasi të kenë kryer trajnimin fillestar për hetim dhe të jenë paisur me çertifikatën përkatëse të lëshuar nga Institucioni që ka kryer trajnimin.

Neni 7 **Ankimi**

Kandidatët konkuroes kanë të drejtën të bëjnë ankim me shkrim te Prokurori i Përgjithshëm për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese.
Afati i ankimit fillon pas pesë ditëve kalendarike nga

- a) Data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit të jetëshkrimit dhe vlerësimit me shkrim për kandidatët që kanë grumbulluar më pak se 40 pikë,
- b) Data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit për kandidatët që kanë marrë pjesë në të tre fazat e vlerësimit të përcaktuara në nenin 6, pika 7 e kësaj rregullore. Ankuesit marrin përgjigje brenda pesë ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor të përcaktuar në shkornjën b) të këtij neni.
- Në përfundim të këtij afati hartohet lista përfundimtare e fituesve.

Neni 8 Dokumentimi

Në çdo fazë të procedurës, veprimet dokumentohen me procesverbal, i cili, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I POLICISË GJYQWSORË

**KRYETARI
ALFRED PROGONATI**



**ANËTAR
BLEDAR ÇELIKU**

**ANËTAR
ERVIN BRAHAJ**

**ANËTAR
HARI GOGO**

**ANËTAR
ALBERT MUÇO**